



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA KUSHTETUESE
KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT

Nr. 20/2021 (JR)
Nr. 20 /4 regj.

Tiranë, më 19.03.2024

**SHPALLJE
E
NJOFTIMIT PËR GJYKIMIN E ÇËSHTJES NË SEANCË GJYQËSORE PUBLIKE**

Nëpërmjet kësaj shpallje, Kolegji i Posaçëm i Apelit, bazuar në nenin 65, pika 1 e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, njofton subjektet pjesëmarrëse në proces, si dhe të gjithë personat e interesuar se sot, më datë 19.03.2024, në seancën e thirrur në orën 10:00, pasi mori në shqyrtim në dhomë këshillimi, çështjen e Juridiksionit të Rivlerësimit, me numër regjistri 20/2021, datë 21.04.2021, për ankimin e subjektit të rivlerësimit Bib Ndreca kundër vendimit nr. 337, datë 18.01.2021, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, vendosi shqyrtimin e çështjes në seancë gjyqësore publike, **ditën e martë, në datën 23.04.2024, ora 10.00.**

Kolegji i Posaçëm i Apelit e mori këtë vendim bazuar në nenin F, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës, nenin 4, pika 5 e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, si dhe në nenin 51, pika 1, shkronja “b” të ligjit nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar, me qëllim konstatimin e plotë të situatës faktike lidhur me burimin e ligjshëm të huasë së huadhënësit P. N. në shumën 5.500.000 lekë për blerjen e apartamentit të ndodhur në rrugën “Jordan Misja” në Tiranë.

Seanca gjyqësore publike do të zhvillohet në selinë e Kolegjit të Posaçëm të Apelit, në adresën Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, Nr. 3, Tiranë.

Trupi Gjykses përbëhet nga gjyqtarët:

Kryesues i Trupit Gjykses
Relatore e Çështjes
Anëtare
Anëtare
Anëtare

Sokol Çomo
Rezarta Schuetz
Albana Shtylla
Ina Rama
Natasha Mulaj

Bazuar në nenin 460, pika 5 e Kodit të Procedurës Civile dhe në nenin 51, pika 2 e ligjit nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar, kjo shpallje bëhet të paktën 10 ditë para seancës së gjykimin, në ambientet e Kolegjit të



Posaçëm të Apelimit, si dhe me njoftim individual në të dhënat e kontaktit të subjektit të rivlerësimit. Ky njoftim bëhet gjithashtu edhe në faqen e internetit të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit.

KRYESUES I TRUPIT GJYKUES

GJYQTAR

SOKOL ÇOMO

